




REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. DPKI	Br. Prot. 06-442/20
Dep.	Prot. No.
Nr. llaq	Data
Broj stranica 03	Datum 21-02-2020
Nr. pages	Date



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.02.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-DPKI-06-01/1826/19, për zyrtaren e lartë publike znj. Besa Shatri - Berisha, Kryesuese e Bordit në Telekomin e Kosovës Sh.A, për shkak se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e hapur për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit me numër protokolli AKK-DPKI-06-01/1826/19, lidhur me zyrtaren e lartë znj. Besa Shatri - Berisha, Kryesuese e Bordit në Telekomin e Kosovës Sh.A, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar informacionin nën dyshimin për konflikt të interesit, sipas të cilit zyrtarja e lartë znj. Besa Shatri - Berisha, duke qenë Kryesuese e Bordit në Telekomin e Kosovës ushtron njëkohësisht edhe funksionin e Drejtorit Ekzekutiv në Organizatën joqeveritare "Asociacioni i Sporteve Ekstreme të Kosovës".

Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm në Institucionet përkatëse, Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e ka njoftuar zyrtaren e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06/3302/19, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ajo ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga pala, me kërkesë të saj është organizuar dhe mbajtur një takim në Agjencinë kundër Korrupsionit, ku zyrtarja e lartë është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, gjatë ushtrimit të funksionit në cilësinë e zyrtares së lartë publike, ajo nuk mundet që krahas ushtrimit të funksionit publik të ushroj funksionin e drejtueses apo përfaqësueses në Organizatë joqeveritare, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 14, paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku thuhet se:

*“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtarja e lartë znj. Besa Shatri-Berisha, është pajtuar tërësisht me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06/302/19), me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë znj. Besa Shatri-Berisha, ka dhënë dorëheqje të paravekueshme nga pozita e Drejtorit Ekzekutiv në Organizatën joqeveritare “ *Extreme Sports Association* ” dhe se e njëjta ka bërë ndryshimet e nevojshme dhe nuk figuron më të jetë person i autorizuar i kësaj organizate.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtarja e lartë znj. Besa Shatri-Berisha, Kryesuese e Bordit të Drejtorëve në Telekomin e Kosovës, janë krijuar rrethana të reja, me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë.

Në dy takimet që janë realizuar në Agjencinë kundër Korrupsionit është trajtuar edhe informacioni sa i përket pozitave tjera që ushtron znj. Besa Shatri-Berisha, e cila mban pozitën e Menaxheres së Kontabilitetit Qendror (Kontrollor) në Korporatën Energjetike e Kosovës me orar të rregullt pune, pozitën Partner rishikues/zyrtar i pajtueshmërisë në Kompaninë Private “*Audit & Conto*” dhe pozitën e Menaxheres së Financave në Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës. Zyrtarja në fjalë ka deklaruar se funksionet tjera i ushtron pas orarit të rregullt të punës dhe pushimeve të fundjavës.

Më datë 27.01.2020, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-147/20, ka kërkuar nga zyrtarja e lartë, kontratat e punës rreth angazhimeve që ka, në mënyrë që të vlerësoj nëse ushtrimi i funksioneve tjera paraqet papajtueshmëri, përkatësisht konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Pas pranimit të dokumentacionit të kërkuar nga znj. Besa Shatri-Berisha, Agjencia e ka trajtuar atë me kujdes dhe më pas ka vlerësuar se ushtrimi i funksioneve nga zyrtarja e lartë nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ndërsa sa i përket pretendimeve nga denoncuesi i këtij rasti se znj. Besa Shatri-Berisha, punon në Kompaninë “*Audit & Conto*” dhe se e njëjta Kompani është partnere në shumë projekte me Kompaninë Private “*Mazars*”, në pyetjet e denoncuesit se a përbën ky rast konflikt të interesi, Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka analizuar me kujdes dokumentacionin, lidhur me aktivitetin

e prokurimit publik “ *Shërbime Profesionale Financiare* ” me nr. të prokurimit:TK-19-2955-225 dhe me nr. të brendshëm TK-19-036-225, nuk ka gjetur prova me të cilat dëshmohet situata e konfliktit të interesit. Kjo për faktin se Kompania “ *Audit & Conto* ”, në të cilën është e angazhuar zyrtarja e lartë nuk është fituese e kësaj kontrate.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtares së lartë publike
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

